

LETRAT E LEXUESVE:

DRITA nr. 11/ 1997

I nderuari baca Shefki!

Dërgimi i revistës suaj "DRITA", nr. 8 dhe 9 më bën t'u drejtohem me falenderime të përzemërta, dërguar nga zemra. Unë e diç vehten edhe ma të pasur me gazetën Tuaj.

U vafshin punët mbarë, Ty e bashkëpunëtorëve! Temat dhe fizionomia e revistës më pëlqejnë. Tani për tani po u dërgoj një poezi, me titull "Besa".

Në gazetën Tuaj e gjeta prof. Shefqet Canhasin, profesorin tim gjatë kohës së studimeve kur unë isha student i tij në SH.L.P. të Gjakovës. Një krenari, një emocion më kaploi kur ia pashë emrin! Ndonëse kanë kaluar dy dekada.

Rruga jetësore e profesor Shefqetit vërtetë është rrugë e revolucionarit të vërtetë. Profesor Shefqeti me kohë pati kryer punën e vet, sepse ai i përkrahu dhe u solidarizua me demonstratat e vitit 1981, e deshi lirinë e drejtësinë, prandaj edhe e patën burgosur.

Edhe një herë, Juve e sidomos bashkëpunëtorin Tuaj dhe profesorin tim të nderuar, dr. Shefqet Canhasin Ju përshëndes!

Isuf Bajraktari
Seminariegatan 5
261 34 LANDSKRONA
Suedi
Tel: 0418 258 56

Tungjatjeta Shefki!
Ju përshëndes Juve dhe familjen Tuaj!
DRITËN nr. 9 e mora sot. Po të them me sinqeritet se më pëlqeu pamasë. Ajo që mua më ka rënë në sy është se çdo numër po del më interesant se tjetri, dhe kjo është për çdo lavdatë. Ju lutem Juve si redaksi dhe bashkëpunëtorëve!

Fatmir Fetiu
4120 3-eme AVE # 2
CHARLESBORG
GIH 6 E 1
QUEBEC
KANADA

Tungjatjeta baca Shefki!
I lexova numrat e fundit të gazetës suaj DRITA (nr. 8,9,10) dhe mbeta i kënaqur jo veç unë por e tërë familja ime. Ju lumtë për punën e madhe që po e bëni në informimin komunitetit shqiptar në Suedi dhe më gjerë. Shaib Gërxhaliu
Weterlundsgatan 21 D
521 34 Falkköping

z. Shefki Oseku!
Para disa ditësh nga një shok imi në Norvegji mu dha rasti ta lexoj gazetën Tuaj DRITA. Revista më pëlqeu. Mendova që edhe unë të shkruaj për një çështje e cila, sipas mendimit tim, është e rëndësishme. Shpresoj se në DRITA do të gjej vend ky punim imi.

Agron Kodra, Norvegji

Revistë kulturore - informative Shoqata Besa, në Trelleborg-Suedi
Kultur-och informationstidskrift Föreningen Besa i Trelleborg-Sverige

DRITA

Viti II
NR. 11/97
Çmimi
30:-



MILAIM ZEKA, VEPRIMTAR NË SUEDI